



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçane
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

05 Nr. 979/2012
Data : 28/12/2012

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, neni 5 pika c, Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës neni 8 si dhe Udhëzimit Administrativ, 17/2009, Drejtoria e Arsimit në Gjiçane shpallë :

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

I. Shkollat Filllore :

1. **Shkolla Filllore "Abaz Ajeti" Gjiçane**
 - 3 (tre) pastrues
2. **Shkolla Filllore "Nazim Hikmet" fsh. Dobërçan**
 - 3 (tre) pastrues
3. **Shkolla Filllore "Selami Hallaqi" Gjiçane**
 - 1 (një) pastrues
4. **Shkolla Filllore "Veseli Muja" fsh. Mehiri**
 - 1 (një) pastrues
5. **Shkolla Filllore "Ramiz Cërnica" fsh. Cërnica**
 - 1 (një) pastrues
6. **Shkolla Filllore "Fetah Qerimi" fsh. Vërbicë e Zhegocit**
 - 1 (një) pastrues

II. Institucionet parafillore

1. **Çerdhja "Integj"**
 - 1 (një) pastrues
 - 1 (një) shtëpiak
2. **Konvikti i nxënësve dhe studentëve**
 - 1 (një) enëlarëse
1. **Shkolla e Mesme-Gjimnazi "Zenel Hajdini"**
 - 1 (një) bibliotekist
 - 1 (një) rojtar
2. **Shkolla e Mesme Ekonomike "Marin Barleti"**
 - 1 (një) pastrues

Kushtet e konkursit :

Kualifikimi për vendet e punës të stafit ndihmës : kërkohet që kandidati të ketë përgatitje të mesme shkollore apo fillore.

Kualifikimi për vendin e punës bibliotekist : kërkohet që kandidati të ketë përgatitje profesionale- Fakulteti i Filologjisë, dega gjuhë dhe letërsi shqipe apo Fakulteti Filozofik, dega e pedagogjisë. Për këtë vend të punës, kandidatët do t'i nënshtrohen testit me shkrim dhe

intervistës me gojë. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë testimin me shkrim, ftohen në intervistë me gojë.

Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente: Diploma, kopja e letërnjoftimit, certifikatat për trajnimet e kryera adekuate, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit si dhe dokumenti nga gjykata kompetente me të cilën vërtetohet se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen, ndërsa dokumentet origjinale prezantohet në intervistë.

Për vendin e punës bibliotekist, të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë vend të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Për vendin e punës - bibliotekist, koeficienti është 4.8, ndërsa për vendet e punës - stafi ndihmës - 4.

Kohëzgjatja e kontratës: sipas Ligjit të Punës

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta dhe në mjetet e tjera të informimit.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbime të Qytetarëve në Gjilan.

Për vendin dhe kohën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës gojore, kandidatët do të njoftohen përmes listës e cila do të vendoset në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin e Qendrës për Shërbime të Qytetarëve.

Në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit.

**Drejtori
Bujar Nevzati**